



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Opština Klokot/Komuna e Klllokot

Datë : 29.05.2020

Në bazë të nenit 17.pika (s,s), nenit të Ligjit për Vetqeverisje Lokale nr.03/L-040,si dhe Statutit të komunës së Klllokotit nr. 10815/2 të datës 31.07.2018 në bazë të nenit 8.pika 8.1 (a,s).Kuvendi Komunal Klllokot në seancën e pestë të rregullt bie :

V E N D I M
2019-2021 MBI PLANIN AKSIONAR KOMUNAL PËR EFIQIENCË ENERGJETIKE
(PAKEE) 2019-2021

Neni 1.

Në seancën e pestë të rregullt të Kuvendit komunal të Klllokotit e mbajtur me datën 29.05.2020. është miratuar vendimi mbi planin aksionar të komunës për efqiencë energjetike PAKEE) 2019-2020.

Neni 2.

Në bazë të propozim vendimit nr. 370/1 të datës 12.05.2020 e parashtruar nga ana e kryetarit të komunës Bozidar Dejanovic në Kuvendin komunal për aprovim të vendimit në titull,delegatët me datë 29.05.2020 seancën e pestë të rregullt të Kuvendit komunal kanë shqyrtuar propozim vendimin e dokumentit të Planit komunal aksionar për efqiencë energjetike (PAKEE) 2019-2020 dhe kanë miratuar vendimin ne seancë që është mbajtur përmes aplikacionit viber për shkak të pandemisë së koronavirusit COVID-19 nga delegatët prezent 11 prej tyre janë deklaruar individualisht në thirrjet e kryesuesit të Kuvendit 10 delegatë kanë votuar PËR ,KUNDËR ishte 1 delegat, deri sa 4 delegatë nuk u deklaruan.

Neni 3.

Qëllimi i këtij plani aksionar për efqiencë energjetike (PAKEE) është që të zvogëloj shepnzimin e energjisë të ngris nivelin e KOMFORIT dhe të zvogëloj ngarkesën e energjisë në komunë dhe në buxhet.

Pritet që PAKEE të ndikojë në komunë e Klllokotit si vijon:

- Reduktimi i konsumit të energjisë në sektorët e ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik;
- Kursime në buxhetin komunal duke ofruar shërbime më efikase të energjisë;
- Përmirësimi i shërbimeve komunale dhe efikasitet në punë;
- Përmirësimi i mbrojtjes sanitare dhe rehati në ndërtesat publike;
- Ulja e emetimeve të CO2 në të gjithë sektorët, përmes zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë, përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, menaxhimit të konsumit, trainimit dhe masave të tjera;
- Rritja e ndërgjegjësimit të politikëbërësve, operatorët dhe përdoruesit përfundimtarë rreth kursimit të energjisë.

Neni 4.

Kryetari dhe Departamenti i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 5.

Ky vendim i referuar në nenin 1 do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga Kryetari i Kuvendit të Komunës së Klllokot. Vendimi do të publikohet në faqen e internetit të uebfaqes komunale.

Kopja :

- MAPL;
- Kabineti i kryetarit të komunës;
- departamenti për ekonomi,financa dhe buxhet;
- kryesuesit të K.K.Klllokot
- Arkivës komunale

Kryesuesi
i Kuvendit komunal Klllokot
Zarko Dejanović
Zarko Dejanović

